

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Denoncimi në Piranja - Qiraja brenda qirasë/ 'Dua 120 mijë euro', si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit!
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/917734/qiraja-brenda-qirase-dua-120-mije-euro-si-u-zaptua-prona-ne-rrugen-e-durresit-zbardhet-skema-e-mashtrimit/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 21:00:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 20:27:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	210ac040436d55cb30e3eeadee8633387d712fac607b81d406419cdb5fcd7d06
TEKSTI	99d61431a437ac0817bcce21ec6d74f84bb27cc879167b1453d55d6964f32bac
PAMJA	1df66fe6ccb0e0f2435de42efa85856290c38d4d97ad15259a3230d8531c052c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ca23b5741f44b8652d7c986efa4fbb91672de2c1c4d04c381b31f434fe19370d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d8fd0ed91dbebc864780a4583f7f7de5df5b250232dc1d3996dcf03dc7a10c89
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ca23b5741f44b8652d7c986efa4fbb91672de2c1c4d04c381b31f434fe19370d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




PROF. MYQEREM TAJ

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!



SONILA MEÇO

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



më të lexuarat



Sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj pronarëve



Blokimi i pagave të gjyqtarëve/ SPAK merr në pyetje përgjegjësen e Thesarit, ja çfarë dimë deri tani




Shpërthim në Shijak! Zbulohet emri i pronarit të banesës ku u vendos eksplozivi



Arrestohet në flagrancë një efektiv policie, dy të tjerë hetohen në gjendje të lirë



Shortohet seanca për Ergys Agasin e Ulian Shpatarakun- Ja kush gjyqtar e ka në dorë



I dhunojnë dhe arrestojnë/ Policia prangos 12 protestues se thirrën: Rama jepe dorëheqjen



Qiraja brenda qirasë/ 'Dua 120 mijë euro', si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit!

22:27, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Jemi në Tiranë, në rrugën e Durrësit, aty ku një apartament është kthyer në 'mollë sherri' dhe ka ndezur debate të ashpra mes pronarëve dhe personave që e kanë marrë me qira, të cilët, në shkelje të kontratës, sot nuk pranojnë të dalin nga shtëpia, duke krijuar një skemë të mirëfilltë mashtrimi, qiraje dhe më pas nënqiraje. Gjithçka nisi kur një person, i quajtur Gentian Zavalani, kërkoi të marrë me qira banesën e çiftit, Lavdije dhe Gëzim Ago.

Por Zavalani ishte veçse një person i përdorur nga Asiola dhe Albert Sula, me qëllim që të merrnin apartamentin, pasi çifti kishte refuzuar prej kohësh t'ia jepnin atij, për shkak të mungesës së besimit. Të gjendur përballë kësaj situatë, çifti Sula gjetën zgjidhjen 'perfekte' duke përdorur Zavalanin.

Kur çifti Ago kuptoi se çfarë po ndodhte, ishte tepër vonë, pasi tashmë Asiola dhe Albert Sula kishin ngritur një strukturë biznesi në pronën e tyre, duke përdorur kontratën e nënqirasë të firmosur me Gentian Zavalanin. Këtu do të nisnin dhe përplasjet, ndërsa në një video, Alberti shihet duke kërcënuar dhe sharë me fjalor banal dhe punonjësit e shtetit.

Nga ajo që kuptojmë, në këtë histori me zaptim prone, është se Alberti ndihet pronar në një shtëpi që e ka marrë me një kontratë nënqiraje, e cila është përpiluar dhe firmosur me hije dyshimi për vërtetësinë e saj e që, për më tepër, i ka humbur efektin.

Sepse, referuar kontratës së qirasë të firmosur më datë 1 gusht 2024, mes Gëzim dhe Lavdie Agos me zotin Gentian Zavalani, në pikën 2 thuhet qartësisht se kjo marrëveshje e humb legjitimitetin e saj më 1 gusht 2025. Dhe vetëm nëse palët bien dakord, 30 ditë përpara afatit të përfundimit të saj, pra në korrik 2025, atëherë kontrata mund të rinovohet edhe për dy vite të tjera.

Ndërkohë, një pikë tjetër e rëndësishme është ajo që përcakton se, nëse nuk bëhet pagesa e qirasë në kohën që është rënë dakord mes palëve, atëherë kontrata do të prishet automatikisht...

Pra, një kontratë e skaduar dhe e shkelur me të dy këmbët nga qiramarrësi, që në fakt është nën/qiramarrës, sepse qiramarrësi i vërtetë, Gentian Zavalani, ka dalë

teresia jashtë rreze.

Por këtu nis një tjetër problem për pronarët e ambientit, sepse Alberti ka pretendime... pasi i kërkon çiftit Ago 120 mijë euro me pretendimin e investimit në pronë.

Për të kuptuar se çfarë ka ndodhur, fillimisht takuam Gentian Zavalanin, i cili duket se ka dhe rolin kyç në këtë histori. Por, në mungesë të argumenteve, ai tenton t'i shmanget përgjegjësisë, derisa në fund, zbërthen skemën e mashtrimit, kërkon ndjesë dhe zotohet se nuk do të bëjë më gabime.

Ndërsa Albert Sula, i cili vijon të qëndrojë në banesë, ka pretendime të tjera. Ai këmbëngul që kontrata e nënqirasë është në konform ligjit dhe se nuk e ka përdorur Zavalanin si karrem për ta marrë fillimisht banesën me qira të çiftit Ago, ndonëse vetë Gentiani e pranon në përballjen me ne se ndihet i përdorur dhe se që në fillim e ka marrë shtëpinë me qira te Lavdia dhe Gëzimi, me qëllim që ajo pronë më pas të përdoret nga Alberti dhe Asiola.

Tashmë çështja është në duart e drejtësisë, e cila ka për detyrë t'i japë zgjidhje përfundimtare këtij konflikti. **/Piranjat**

© SYRI.net

Lexo edhe:



VIDEO/ Tmerri i 40-vjeçares në Vlorë, si u shndërrua njohja e re në një kalvar përndjekjeje, shantazhi dhe denigrimi



Vlorë/ Zjarr në kuzhinën e një restoranti në Skelë, flakët përfshijnë garazhin nëntokësor



Nga denoncimi te drejtësia/ 6 vite burg për Elton Sinën, pas investigimit të 'Piranjave'

Laboratori i heroinës në Has dhe dosja '339', arrestohet në Belgjikë Jasin Avdyli! Fitimet i investoi në dy lokale në Shijak

Shtyhet seanca ndaj Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit, mungoi anëtari i trupit gjykues

Arratisje si në filma/ Forcat speciale spanjolle arrestojnë shqiptarin me ... mbi 80 precedentë penalë

TË NGJASHME



Këta janë 3 fierakët që humbën jetën tragjikisht në aksident në Athinë



Fëmija 1 vjeçar dëmton dorën me grirëse mishi, niset me helikopter drejt Tiranës



Po shoqëronte vajzën për në shkollë, 42-vjeçarja shqiptare përplaslet për vdekje nga kamioni



Erion Veliaj del nga burgu, dërgohet me ambulancë në spital



Grabitet apartamenti i kardinalit Ernest Simoni në Firence, ja çfarë morën hajdutët.... Nipi: Kur e njoftova më pyeti për



Emri i një pensionisti u përdor për ndryshimin e 45 identiteteve. Pezullohen 2 zyrtarë, Indrit Aliu shpallet në kërkim



Pagat e magistratëve/ Shefja e Thesarit, Tiranë: Kreva pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoi Malaj...

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net